



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI**

Nr 1255/2 Prot

Datë 31/12/2016

V E N D I M

Nr. 190, Datë 31/12/2016

PËR

**EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TEMATIK TË
USHTRUAR NË KONTROLLIN E LARTË TË SHTETIT, ME OBJEKT
“MBI NGRITJEN E STRUKTURAVE DHE IMPLEMENTIMIN E
PROJEKTIT IPA 2013 ‘FORCIMI I KAPACITETEVE TË AUDITIMIT
TË JASHTËM NË SHQIPËRI’, NË KLSH”**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, në mbështetje të nenit 10 dhe 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

- I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi ngritjen e strukturave dhe implementimin e projektit IPA 2013 ‘Forcimi i Kapaciteteve të Auditimit të Jashtëm në Shqipëri’, në KLSH”
- II.** Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Në kuadër të asistencës për Shqipërinë dhe të zbatimit të Instrumentit të Parazgjerimit, IPA 2013, komponenti i I-rë, KLSH ka fituar një financim nga Bashkimi Evropian për “*Forcimin e kapaciteteve të Auditimit të Jashtëm*” me vlerë 2.1 milionë €. Projekti ishte ndër 7 projektet e përzgjedhur nga BE, për t’u implementuar në mënyrë të decentralizuar, nga institucionet e shtetit shqiptar. Ky projekt përbën një mbështetje të fortë por njëkohësisht është edhe sfida e radhës për institucionin e KLSH-së, i cili synon të shndërrohet në një trupë profesionistësh që ecën në rrugën e modernizimit dhe të realizimit të Auditimeve në përputhje të plotë me standardet INTOSAI dhe praktikat më të mira të *Acquis Communautaire* të Bashkimit Evropian. Në përfundim të procedurave të prokurimit është zhvilluar procesi i vlerësimit i cili ka konkluduar me Raportin e Vlerësimit të datës 16.12.2014 dhe me vendimin se propozimi i konsorciumit Poloni-Kroaci është përzgjedhur si fitues i implementimit të këtij projekti në përputhje me kërkesat e Fishës së Binjakëzimit.

Kontrata e implementimit të projektit është nënshkruar, në datën 17.02.2016, ndërmjet z. Wojciech Kutyla zv. President i NIK-ut dhe zj. Luljeta Nano, Sekretare e Përgjithshme e KLSH-së dhe z. Manol Simo, Drejtor i Përgjithshëm i CFCU.

Kohëzgjatja e projektit është 2 vjeçare dhe ai ka filluar në 16 Mars 2016.

Nga auditimi i kryer rezultoi se KLSH në vijimësi ka bashkëpunuar me ekspertët e misioneve të dy institucioneve supreme të auditimit partnere të Nik-ut Polak dhe të SAI-t Kroat, duke mbështetur në mënyrë të suksesshme implementimin e projektit.

Konstatohet se angazhimi i stafit të KLSH-së përgjatë implementimit të projektit ka qenë një ndër prioritetet e veprimtarisë menaxheriale institucionale pa cenuar dhe anashkaluar veprimtarinë audituese në përmbushje të detyrimeve kushtetuese dhe ligjore.

Nga auditimi i kryer rezultoi se deri me 16.11.2016 (8 muaj nga bërja efektive) është konsumuar 33% e kohës totale të projektit, gjatë implementimit janë zhvilluar 356 (34%) dite/ekspertë dhe janë realizuar 29 misione (33%).

U konstatua se aktivitetet dhe misionet janë kryer konform parashikimeve të kontraktuara si dhe produktet dhe out-putet e gjeneruara rezultojnë sipas parashikimeve në skedulat dhe fishat respektive të projektit.

Në funksion të forcimit të kapaciteteve nga ana ekspertëve të projektit janë adresuar 116 rekomandime për KLSH-ne në cilësinë e institucionit përfitues i projektit.

Këto rekomandime kryesisht përfshijnë propozime për ndryshime të akteve rregullative të KLSH-së, dokumentet të politikave menaxheriale të burimeve njerëzore, udhërrëfyes të procedurave të brendshme, rishikimin e manualeve, metodologjive të planifikimit të auditimeve bazuar në risk, rishikimit të kuadrit të kontrollit dhe sigurimit të cilësisë etj.

Nga ana e njësisë së implementimit të projektit në bashkëpunim me këshilltaren rezidentet të projektit po punohet për evidentimin e të gjitha rekomandimeve të adresuara në funksion të hartimit të një matrice të implementimit të rekomandimeve.

Për sa më sipër rekomandojmë:

1. Departamenti i Politikave të Auditimit në bashkëpunim me Njësinë e Implementimit të Projektit IPA 2013 të përgatisë urdhrin për zbatimin nga ana e strukturave përgjegjëse të

rekomandimeve të adresuara nga Misionet e zhvilluara në kuadër të implementimit të projektit IPA dhe të fokusuara në tre komponentët:

- i) Përmirësimi i kuadrit ligjor i për auditimet;
- ii) Zhvillimi i metodologjisë së auditimit dhe kapaciteteve të raportimit
- iii) Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe përmirësimi i impakteve të rezultateve të veprimtarisë audituese të KLSH-së.

Brenda datës 15.02.2017 dhe në vazhdimësi

2. Kontrolli i Lartë i Shtetit, gjatë procesit të hartimit të dokumentit të *Strategjisë së Zhvillimit të Institucionit për periudhën 3-vjeçare vitet 2018-2021*, të konsiderojë rekomandimet e adresuara nga ekspertët e misionit IPA në drejtim të komponentëve të zhvillimit të kapaciteteve institucionale të KLSH-së, përmirësimit të kuadrit rregullator në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikatat e mira të Acquis Communautaire, zhvillimit dhe konsolidimit të auditimeve financiare, të performancës, të teknologjisë së informacionit, rritjes së rolit të KLSH-së në mirë qeverisje dhe luftës kundër korrupsionit, rritjes së mbikëqyrjes parlamentare nëpërmjet përdorimit të mekanizmave efektive të përdorura gjerësisht nga komunitetit i INTOSAI-t etj.

Në vazhdimësi

3. Marrë shkas nga përcaktimi në nenin 39 “Trajnimet profesionale”, pika 2, Ligji 154/2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, sipas të cilit: “*Kontrolli i Lartë i Shtetit siguron një proces sistematik dhe të planifikuar të trajnimit, zhvillimit profesional dhe certifikimit,...*” si dhe në referencë të eksperiencës praktikave më të mira të fushës dhe rekomandimeve të ekspertëve të implementimit të projektit IPA, lidhur me skemën e certifikimit të audituesve të jashtëm publik, **rekomandojmë:**

Kontrolli i Lartë i Shtetit, të ngrejë një grup pune dhe në bashkëpunim me Komisionin për Ekonominë dhe Financat në Kuvendin e Shqipërisë, të ndërmarrë iniciativën ligjore për ndryshimin e nenit 39 të ligjit nr. 154/2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në funksion të përcaktimit të qartë të detyrimit të institucionit të KLSH-së për të certifikuar audituesit e jashtëm të sektorit publik.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Drejtoria e Auditimit të Brendshëm .

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R